



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:051218

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05515208

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Driton Sadiku, me bashkëpunëtoren profesionale Fjolla Osmani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit T.M., nga fshati Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK-së), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1735/23, të datës 13.02.2024, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datën 14.03.2024 në prezencën e prokurorit të shtetit Azem Islamaj dhe të akuzuarit, me datën 15.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 27.03.2024 e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

T.M., nga i ati ..., e ëma .., e vajzërisë ..., i lindur me datën .., në fshatin ..., Komuna e Gjakovës, me vendbanim të rregullt në Zvicër, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme (zanatin për punëtor sigurimi në Zvicër), punon si sigurim në Zvicër, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ...

Ë S H T Ë F A J T O R

Më parë, në vazhdimësi e deri me datën 03.12.2023, në Gjakovë, përfshihet në sjellje të vëmendjes se vazhdueshme dhe të padëshirueshme me qëllim të frikësimit ndaj personit tjetër dhe atë ndaj të dëmtuarit H.H., në atë mënyrë që, i pandehuri fillimisht me datën 10.11.2023, i len mbi veturë të dëmtuarit një letër dhe një numër telefoni duke i thënë “*H. thirrrem njëherë*” e pasi i dëmtuari e thërret disa herë i pandehuri nuk lajmërohet në telefon, ndërsa me pas i

pandehuri me datat 12 - 15.11.2023, i dërgon mesazhe me përmbajtte kërcënuese “*Kisha pas qejf me dal me ty, te bisedojmë do gjana rreth A. të jesh në ngjarje kur të kthena nga Zvicra kisha pas qejf të ju informoi për gjestin se e keni bo ndaj meje se e keni martu qiken e juaj në vend të gabuar se atë femer ska lind kush as ska me lind se ka me e gzu jashta meje ta keni me dije se unë e kalli Gjakovën, për atë qik, se e heki një zhugan si Sh.J., si lepurin e heki se ajo qika mi ka hup 5 T.M., dhe kërkon takim me të, ku si pasojë me këto veprime të dëmtuarin e vë nën shqetësim të madh emocional.*

- me këto veprime ka kryer vepër penale ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 182 par.1 të Kodit Penal të Kosovës, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej tetëqind (800.00) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimin me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dyzetë (40) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20) euro.
- III. I dëmtuari H.H., nga Gjakova, rruga “...”, p.n, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- IV. Detyrohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë me datën 14.02.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1735/23, të datës 13.02.2024, ndaj të akuzuarit Tush, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 14.03.T.M.,. Gjatë shqyrtimit fillestar prokurori i shtetit ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari T.M., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se është penduar për këto veprime, ka qenë pak sa nën ndikim të alkoolit, shton se e ka parë të dëmtuarën edhe pas rastit dhe nuk i ka thënë asgjë e as nuk i ka bërë diçka, e po ashtu kurrë nuk e ka thirrur e as nuk i ka shkruar asgjë, ka kërkuar falje për atë që ka ndodhur, si dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë më asnjë vepër penale.

Prokurori i shtetit, Azem Islamaj, duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas sqarimit të mjaftueshëm lidhur me aktakuzën, duke i sqaruar benefitet e këtij pranimi të fajësisë, si dhe për faktin se ky pranim i fajësisë gjen mbështetje edhe në prova të cilat janë bashkëngjitur kësaj aktakuze, gjykatës i propozojmë që ky pranim i fajësisë të aprovohet. Gjykatës i ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të vlerësoi pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret rrezikshmëria e veprës, si dhe mosha e shtyre e të dëmtuarit, i cili është në moshën 67 vjeçare, ku njëherit konsiderohet si viktimë e ndjeshme.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk

ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari T.M., me dashje ka kryer veprën penale ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 182 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale ngacmimi: *“Kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.*

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethana lehtësuese që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: rrethanën se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nga evidenca penale nuk rezulton se më herët ka kryer ndonjë veprë penale; në gjykatë ka pasur sjellje korrekte; në deklarin e tij në shqyrtim fillestar i njëjti ka shprehur pendimin e tij për veprën e kryer dhe ka kërkuar falje dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë më asnjë veprë penale; si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes nga i pandehuri në kryerjen e veprës penale ashtu që i njëjti pasi fillimisht me datën 10.11.2023, i len mbi veturë të dëmtuarit një letër dhe një numër telefoni duke i thënë “*H. thirrem njëherë*” e pasi i dëmtuari e thërret disa herë i pandehuri nuk lajmërohet në telefon, ndërsa me pas i pandehuri me datat 12.11.2023 dhe 15.11.2023, i dërgon mesazhe me përmbajtje kërcënuese të përkrahura si dispozitiv, ndërsa me datën 03.12.2023, përsëri e thërret të dëmtuarin në telefon, i prezantohet si T.M., dhe kërkon takim me të. Po ashtu si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh edhe moshën e viktimë, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës relativisht të vjetër, përkatësisht i moshës gjashtëdhjeteshtatë (67) vjeçare.

Kështu që duke marr parasysh rrethanat e lartpërmendura, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Kërkesa pasurore juridike

Gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPP-së, të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil për realizimin e kërkesës së tij juridiko – pasurore.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2024:051218, me datën 27.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Fjolla Osmani

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Driton Sadiku

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.